



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri anëtarë, Adnan Konushevci, anëtarë dhe me zyrtaresen e lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me apelin e Iniciativa Qytetare Serbe (G.I.Srpska Lista), me seli në Komunën e Graçanicës, kundër vendimit me nr. 486/2017 të datës 12.05.2017, të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me seli në Prishtinë, në seancën e panelit të mbajtur me 17.05.2017, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET si i palejuar apeli i Iniciativa Qytetare Serbe (G.I.Srpska Lista) me seli në Komunën e Graçanicës.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel nga përfaqësuesi i G.I. Srpska Lista, kundër vendimit të KQZ-së me nr. 486/2017 të dt.12.05.2017, me të cilin është pranuar kërkesa për regjistrim e subjektit politik Partia e Serbëve të Kosovës, (PSK).

Parashtruesi i apelit thekson se vendimi i ankimuar, është marr pa bazë dhe është shkelur neni 12 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe neni 5 i Rregullës nr. 1/2013, për Regjistrimin dhe Veprimin e Subjekteve Politike, sepse Statuti i subjektit politik Partia e Serbëve të Kosovës, (PSK) ka mangësi, dhe është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, dhe si i tillë ky subjekt politik nuk i plotëson kriteret për të ja aprovuar regjistrimin.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi ZRPPC-në më datën 16.05.2017, për apelin që është bërë ndaj vendimit të KQZ-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj apelit deri më datë 16.05.2017 deri në ora 16:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga ZRPPC-ja, në të cilën theksohet se, Zyra më datë 4 prill 2017, ka pranuar aplikacionin për regjistrim të iniciativës politike me emrin “Srpska Lista” me shkurtesën SL. Pas kontrollimit dhe verifikimit të aplikacionit të kësaj iniciative politike, Zyra i ka dhënë afat edhe 5 ditë për të bërë ndryshime konform legjislacionit në fuqi. Sipas përgjigjës në ankesë kjo iniciativë brenda afatit të caktuar ka plotësuar dhe ndryshuar dokumentacionin sipas kërkesës së Zyrës duke ndryshuar edhe emrin e Partisë në “Partija Kosovski Serba” me akronimin PKS, si dhe llogon e saj.

Zyra më datë 15.05.2017 i ka rekomanduar KQZ të bëjë regjistrimin e partisë PKS, duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar konform nenit 12 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullës nr. 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, si dhe nenin 1 të Statutit të saj ku përcakton qartë respektimin e ligjeve të Republikës së Kosovës.

KQZ më datë 15.05.2017, ka marr vendim për të regjistruar subjektin politik "Partija Kosovskih Serba" me akronimin PKS, cila në bazë të Rregullës nr 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike e obligon subjektin politik PKS që brenda 6 muajve të mbaj kuvendin zgjedhor, në të cilin zgjidhet kryetari dhe organet tjera vendimmarrëse të partisë dhe miratohet Statuti i saj.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi bazën juridike për paraqitjen e apelit, gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli vlerëson se në rastin konkret parashtruesi i apelit nuk ka bazë ligjore për ankimin e vendimit të KQZ-së, me Nr. 486/2017 i datës 15.05.2017, sepse është e specifikuar qartë në dispozitën ligjore të nenit 122 Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, se në cilat raste mund të ankimohen vendimet KQZ-së, në PZAP ngase sipas nenit 63 par. 6, të LZP-së, nuk është i lejuar ankimimi ndaj të gjitha vendimeve të KQZ-së, përveç atyre të parapara me ligj.

Prandaj paneli, nuk është lëshuar fare në shqyrtimin e pretendimeve ankimore në këtë rast për faktin se, PZAP-i, nuk ka mandat ligjor në baze të dispozitave të sipërcituara të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.01/2013, për Regjistrimin e dhe Veprimin e Partive Politike, që të vlerësoj ligjshmërinë e vendimit të KQZ-së përkitazi me regjistrimin e një subjekti politik nga KQZ-ja, siç është në rastin konkret. Vlerësimi i ligjshmërisë i një vendimi të kësaj natyre lejohet vetëm në rastet kur refuzohet kërkesa e subjektit politik për regjistrim, sipas nenit 122 par.1 pika (f) të LZP-së.

Për arsyet e theksuara më lart dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 1/2017 më datën 17.05.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.